



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:031317

Datë: 20.08.2020

Numri i dokumentit: 01070394

P.nr.39/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci me Sekretaren Juridike Shere Desku, në çështjen penale kundër të pandehurit: Sh. (T.) K., K. Klinë, për shkak të veprës penale: Dhunë familje, nga neni 248, par.1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.Nr.2842/19, të dt.27.02.2020, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurori i Shtetit: Arben Hoti , nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurit të lartë cekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt.12.08.2020, në të njëjtën ditë publikisht shpalli aktgjykimin, kurse me datën: 14.08.20120 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Sh. K., i lindur nga babai- T.it dhe nena F. e gjinisë K., i lindur dt....., K Klinë, ku edhe tani jeton, martuar baba 3 fëmive, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet me nr. personal:, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

I.Me dt. 27.11 2019, rreth orës 16:30, minuta, në K Klinë, pikërisht në shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare, me qëllim të cenimit të dinjitetit, ushtron keqtrajtim psikologjik ndaj viktimës bashkëshortes së tij L. G., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të atëçastshme që kishte i pandehuri me të dëmtuarën lidhur me vendosjen e disa perdeve, i pandehuri fillon të bërtas duke e qortuar dhe duke e ofenduar të dëmtuarën.

Me çka ka kryer veprën penale: “Dhunë në familje”, nga neni 248, par.3 të KPRK-së

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 50, 51, 52 dhe 73 si dhe nenit 323, par.1, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK

II. Më parë e gjerë me dt.27.11 2019, në fsh. Përqevë K Klinë, pikërisht në shtëpinë e tij, në kundërshtimin me ligj për Armët (05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll pistoletën e llojit „P.38”, modeli 635 me numër serik ...dhe ..., një karikator dhe 6 fishekë të kalibrit 9x19 m m, në atë mënyrë që policia gjatë bastisjes së shtëpisë së të pandehurit, të njëjtit gjejnë dhe sekuestrojnë armën e lartëcekur.

- Me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedon të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 50, 51, 52 dhe 73 si dhe nenit 248, par.1, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, :

G J Y K O N **DËNIM ME KUSHT**

I.Të akuzuarin: Sh. K., me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, dhe dënim me Gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqind) Euro, të cilat dënime, nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale.

II.LIROHET: i akuzuari nga shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe nga shpenzimet për kompenzim të viktimave të krimit, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

III. UDHEZOHET: Pala e dëmtuar: L. Bajram G. nga fshati Përqevë K. Klinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzë, PP.II.Nr.2842/19, të dt: 27.02.2020, ka akuzuar të akuzuarin: Sh. K., nga fshati Përqevë K Klinë, për shkak të veprave penale „ **Dhunë ne familje**” nga neni 248 par 1 të KPRK-së, si dhe vepra penale „mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Fillimisht gjykata bëri **VEQIMIN** e procedurës për veprën penale, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së. Gjukata duke u bazuar në njoftimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me Agj. Nr. 156/2020, i dërgon në kompetencë të Krimeve të Rënda Konform nenit 22 të KPPRK-së, qe parasheh për veprën penale mbajtje në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së,

Gjukata kambajt seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 12.08.2020, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit: Arben Hoti ,nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe i akuzuari i lartë cekur, vetëm për veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 të KPRK-së.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale Dhuna në familje, për të cilën akuzohet, dhe ka shtuar se kërkoj falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, meqë është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj dënim më të butë dhe të ketë parasysh gjendjen ekonomike-familjare.

Prokurori i Shtetit: Arben Hoti, nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimin të fajësisë , pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht: Prokurorit të Shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248, par.1, të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248, par.4, të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale „**Dhuna në familje nga neni 248 par 1 te KPRK-së**”, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndien keqardhje për veprën e kryer për të cilën edhe i kërkon falje gjykatës, faktin se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të bie ndesh me ligjin, gjendjen ekonomike-familjare, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh dashjen e kryerjes së veprës penale.

Gjykata konform nenit 75 të KPRK-së, si rrethanë posaqerisht lehtësuese muar gjendjen e rëndë shëndetësore i cili ishte Invalid dhe këmbën e kishte në protezë, si dhe i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes dhe jeton nga ndihma sociale.

Gjykatës ia ka prezantuar dëshminë se është shfrytëzues i NS nga QPS në Klinikë me nr. Të regj. ... si dhe librezën e Hendikosit.\

Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, par.1, të KPRK-së, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave ligjore të nenit 453, par.4, të KPPRK-së, gjykata e liron të pandehurin nga kompensimi i paushallit gjyqësor dhe nga kompenzimi i tarifës për viktima të dhunës.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463, të KPPRK-së, u vendos për kërkesën pasurore juridike duke udhëzuar palët e dëmtuara që kompensimin e dëmit ta realizojnë në kontest të rregullt juridiko-civil.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25, par.2, 26, par.2, 297, 365 dhe 470 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr.39/20 më dt: 14.08.2020

Sekretare Juridike
Shere Desku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e
pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në
Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.